

REPUBLIKA E SHQIPERISE

“RevoTrade” SHPK

Adresa: Rruga “Nexho Konomi ,Kompleksi Green City,Godina Nr 2,Kati 6 ”,Tirane

Tirane, me 25.03.2025

**AKTI I THEMELIMIT
DHE
STATUTI I SHOQERISE TREGTARE
“RevoTrade” SHPK**

Ne baze te Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” dhe ne Ligjit Nr. 9723 date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”, une i nenshkruari Renald Ngjeliu shpall si me poshte vijon:

FORMIMI I SHOQERISE

Neni 1

Formohet Shoqeria e quajtur **“RevoTrade” SHPK**, qe me poshte do te quhet Shoqeria. Ajo do te kete nje Ortak te Vetem, z. Renald Ngjeliu, lindur ne Fier, banues ne Tirane ne adresen: Rruga “Nexho Konomi ,Kompleksi Green City,Godina Nr 2,Kati 6” me ID I 60716092 K.

SELIA E SHOQERISE

Neni 2

Selia zyrtare e Shoqerise Tregtare **“RevoTrade” SHPK** ndodhet ne adresen: Rruga “Nexho Konomi ,Kompleksi Green City,Godina Nr 2,Kati 6. Shoqeria Tregtare zhvillon aktivitetin e saj ne te gjithë territorin e Republikës se Shqiperise dhe jashte saj. Per kete ajo mund te hape edhe seli te tjera operative, filiale, perfaqesi dhe agjenci ne te gjithë territorin e Republikës se Shqiperise dhe jashte saj, ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe ligjet e vendeve ku ato hapen.

KOHEZGJATJA

Neni 3

Kohezgjatja e veprimtarise ekonomike e Shoqerise Tregtare **“RevoTrade” SHPK** eshte e pakufizuar. Ajo mund te shperbehet ne çdo moment, sipas vendimeve te marra nga Asambleja e Ortakeve.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Neni 4

Objekti i veprimtarise per Shoqerine **“RevoTrade” SHPK** do te jete: Tregetimi me pakice dhe Import Eksport i te gjitha llojeve te mallrave,pajisjeve dhe materialeve te ndryshme ndertimi , industriale,hidraulik,elektrik,panelet dhe konstruksione metalike , pajisje informatike ,elektronike,artikuj te ndryshem elektroshtepiake , konfeksione,materiale pastrimi ,dezinfektimi, maska,doreza sterile,vegla pune,veshje pune ,veshje te mbrojtjes ne pune,doreza , maska,helmeta, kepuce pune ,materiale per sigurine ne pune ,pajisje kundra zjarrit.Tregetim i automjeteve makinerive bujqesore,makinerive te renda me zinxhire,mjete lundruese,motocikletave pjese kembimi,goma,vajra,filtra.Impiante te ndryshme elektrike , hidraulik, ngrohje – ftohje ,Elektromotorra ,Gjeneratora,Transformatora
Furnizime mallra si kancelari,fletepalosje, postera, banderola, broshura.



Neni 5

Kjo Shoqeri mund te ndryshoje emertimin e saj, vendqendrimin, objektin e aktivitetit, te shtojte ortake, te rrise kapitalin sipas vendimeve te asamblese se ortakeve.

KAPITALI I SHOQERISE

Neni 6

Kapitali themeltar i Shoqerise Tregtare "**RevoTrade**" SHPK eshte 500 000 (Peseqind mije) leke dhe i ndare ne nje kuote me vlere nominale 500 000 (Peseqind mije) leke secila. Kapitali eshte kontribut i Ortakut te Vetem te Shoqerise.

Neni 7

Ky kapital mund te shtohet sipas dispozitave ligjore dhe sipas Vendimit te Ortakut

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

Neni 8

Shoqeria Tregtare "**RevoTrade**" SHPK deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave qe permban ky Statut dhe ato te legjislacionit shqiptar ne fuqi. Ajo konsiderohet e krijuar ne daten e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit te Shoqerive Tregtare prane QKR-se dhe e ushtron aktivitetin ekonomik me regjistrimin si subjekt privat ne Zyren e Tatim - Taksave. Emertimi i Shoqerise, Kapitali Themeltar dhe emri i Administratorit te saj duhet te figurojne ne te gjitha aktet ose dokumentet e nxjerra prej shoqerise dhe qe u drejtohen te treteve.

Neni 9

Ortaku i Shoqerise me krijimin e kesaj shoqerie pjesen e kapitalit te derdhur nuk mund ta terheq. Kjo behet vetem pasi nxirret bilanci i Shoqerise per fitimi e realizuar.

Neni 10

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie. Ato jane lirisht te transferueshme edhe ne rast ndarjeje pasurie. Gjithashtu jane lirisht te transferueshme ndermjet bashkeshorteve, si dhe ndermjet paraardhesve e pasardhesve. Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve. Pjeset e kapitalit themeltar mund t'iu transferohen personave te trete qe nuk bejne pjese ne Shoqeri, vetem me miratimin e shumices se ortakeve qe perfaqsojne te pakten 3/4 e pjeseve te kapitalit themeltar. Projekti i transferimit i njoftohet Shoqerise dhe secilit prej ortakeve. Ne rast se Shoqeria nuk e ka bere te ditur vendimin e saj, brenda tre muajve nga data e njoftimit te fundit, miratimi i transferimit konsiderohet i dhene. Ne rast se Shoqeria refuzon te jape miratimin e transferimit, ortaket, brenda tre muajve nga data e ketij refuzimi, duhet te blejne apo te lejojne blerjen e pjeseve te kapitalit themeltar. Transferimet e pjeseve te kapitalit themeltar duhet te vertetohen me nje akt noterial.

Neni 11

Emertimi i Shoqerise Tregtare, forma ligjore e shoqerise, numri unik i identifikimit, vendndodhja e shoqerise, emri i administratorit, duhet te jene te permenduar ne te gjitha aktet e nxjerra nga kjo Shoqeri, nepermjet perdorimit te letres apo mjeteve elektronike, dhe qe ju drejtohen te treteve. Shoqeria ka vulen e saj me permbajtjen e Shoqerise Tregtare "**RevoTrade**" SHPK. Ajo ka llogarite e saj ne leke dhe valute.

Neni 12

Shoqeria vepron nen regjimin e prones private dhe merr persiper vete te drejtat dhe detyrimet kontraktore dhe jashtekontraktore. Ortaku i Shoqerise perballon humbjet vetem deri ne kufirin e vleres se kontributit te tij ne kapitalin themeltar. Ortaket e Shoqerise drejtojne procesin per zhvillimin e aktivitetit te shoqerise si dhe per detyrimet qe ka shoqeria ndaj te treteve pa asnje kufizim. Organet e Shoqerise jane: Asambleja e Pergjithshme dhe Administratori



ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

Neni 13

Organi me i larte i Shoqerise eshte Asambleja e Pergjithshme. Në përputhje me dispozitat e Ligjit dhe pa cënuar të drejtat që rrjedhin nga kuotat ekzistuese, kuotat mund të emetohen me të drejtat ose kufizimet e parashikuara në vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicën e kualifikuar (tre të katërtat) të votave së ortakëve, në përputhje me parashikimet e nenit 87 të Ligjit.

TE DREJTATAT DHE KOMPETENCAT E ASAMBLESE

Neni 14

Asambleja eshte e zakonshme dhe e jashtezakonshme. Asambleja e Zakonshme mblidhet te pakten nje here ne vit, dhe sa here eshte e nevojshme per te mbrojtur interesat e shoqerise. Kompetencat e Asamblese se Zakonshme jane:

- Aprovon çdo lloj veprimi financiar qe me ligj dhe me marreveshje lihet ne kompetencen e Asamblese.
- Percakton shperblimin per administratorin, ekspertet, revizoret kontabel.
- Ka te drejte te miratoje bilancin e shoqerise dhe te beje ndarjen e fitimit.
- Vendos edhe per çdo çeshteje qe nuk sjell ndryshime ne statutin e shoqerise ose nuk i eshte lene ne kompetence Asamblese se Jashtezakonshme.

Asambleja e Jashtezakonshme:

Ne mbledhjen e Asamblese se Jashtezakonshme vendimet do te jene te vlefshme ne rast se ato do te merren nga ortakët qe perfaqesojne te pakten $\frac{3}{4}$ (tre te katerten) e pjeseve te kapitalit themeltar. Asambleja e Jashtezakonshme e ortakëve ka kompetencat e meposhteme:

- Te marre ne shqyrtim dhe ka te drejte te miratoje te gjitha ndryshime e statutit.
- Ben transferimin e kuotave tek te tretet.
- Realizon blerjen, shitjen, dhe transferimin e pasurive te paluajtshme te shoqerise etj. dhe vendos ne lidhje me kete çeshtje.
- Vendos ne lidhje me çdo çeshtje te lidhur me pasurine e shoqerise, marrje hua, vendosje hipoteke, barre siguruese etj.
- Vendos per pjesemarrjen ne shoqeri per hapje dege, filiale, zyra perfaqesimi etj.
- Si dhe çdo çeshtje tjeter qe nuk eshte ne kompetencen e Asamblese se Zakonshme.

Neni 15

Vendimet e Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakëve te cilat jane marre ne nje mbledhje te thirrur ne menyre te rregullt dhe konform kontrates se themelimit, Statutit e te ligjeve jane te detyrueshme per te gjithë ortakët e tjere, edhe per ata qe kane diskutuar ose qe nuk kane qene dakord. Secili ortak qe ka te drejten e pjesemarrjes ne Asamble mund te perfaqsohet edhe nga nje person tjeter i autorizuar me shkrim nga ortaku i Shoqerise. Nje ortak mund te perfaqsohet nga nje ortak tjeter. Nje ortak nuk mund te ngarkoje nje mandatmbajtës te votoje ne emer te nje pjese te kapitalit themeltar, duke votuar ai vete ne emer te pjesës tjeter te kapitalit themeltar. Ne Asamblene e Ortakëve marrin pjese nese eshte e nevojshme per te dhene mendim eksperte, revizore etj.

Neni 16

Marrja e vendimeve te Asamblese, mbajtja e proces-verbaleve dhe te gjitha dokumentat e tjera qe kane te bejne me te duhet te behen sipas legjislacionit ne fuqi.

ADMINISTRIMI

Neni 17

Shoqeria administrohet nga administratori, i cili caktohet ne statutin e shoqerise dhe me pas nga Asambleja e Ortakeve. Administratori qendron ne detyre per nje periudhe 5-vjeçare me te drejte riperseritje. Ne rast se gjate ksaj periudhe shfaqen probleme paaftesie nga ana e tij, Asambleja e Ortakeve vendos shkarkimin e administratorit duke treguar me fakte demin qe i eshte shkaktuar shoqerise nga paaftesia e tij, pasi eshte dhene mendimi per kete dem edhe nga specialistet perkates. Administrator i shoqerise eshte z. Renald Kozma Ngjeliu, i identifikuar me ID me numer personal: I 60716092 K.

Neni 18

Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne marredhenie me te tretet ne emer te shoqerise, ne te gjitha rrethanat, me perjashtim te kompetencave qe ligji ua jep shprehimisht ortakeve. Ai ka dhe te drejten e delegimit te kompetencave. Shoqeria merr persiper detyrimet qe rrjedhin nga aktet e administratoreve edhe kur keto akte nuk perfshihen ne objektin e shoqerise. Shoqeria nuk merr persiper pasojat ndaj te treteve, kur ajo provon se te tretet e dinin qe akti i administratoreve e kalonte objektin e shoqerise ose kur te tretet nuk mund ta injoronin kete akt ne rrethanat e dhena, duke patur parasysh faktin se vetem shpallja e statudit nuk eshte prove e mjaftueshme.

Neni 19

Administratori eshte pergjegjes individualisht ose solidarisht, sipas rastit ndaj Shoqerise ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te Statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te Shoqerise. Asnje vendim i Asamblese nuk mund te ndaloje kerkese padine kunder administratorit per gabimet e kryera prej tyre gjate ushtrimit te detyres.

Neni 20

Administratori shkarkohet me vendim te ortakeve qe perfaqesojne me teper se gjysmen e pjeseve te kapitalit themeltar. Ne rast se shkarkimi eshte bere pa arsye te drejte, ai le shkak per demshperblim financiar. Pervec kesaj, administratori shkarkohet nga gjykata per shkelje te ligjit, me kerkese te çdonjerit prej ortakeve.

Neni 21

Administratoret ose ortaket qe nuk jane persona juridike nuk u lejohet te kontraktojne ne çfaredolloj forme qofte, te marrin hua tek Shoqeria, te japin pelqimin ne emer te saj per paradhenie, si dhe te behen dorezanes apo te garantojne ne emer te saj angazhimet ndaj te treteve. Kjo mase ndaluese zbatohet edhe ndaj perfaqesuesve ligjore te ortakeve qe jane persona juridike. Kjo mase zbatohet gjithashtu ndaj bashkeshorteve, paraardhesve dhe pasardhesve te personave te cituar ne paragrafin e pare te ketij neni, si dhe ndaj çdo personi ndermjetes.

MARREDHENIET E PUNES

Neni 22

Marredheniet e punes ne Shoqerine Tregtare "RevoTrade" SHPK rregullohen nepermjet kontrates se punes. Per çeshtje qe nuk rregullohen me kontrate pune zbatohen dispozitat perkatese te legjislacionit shqiptar ne fuqi.

Shoqeria merr persiper qe te respektoje rregullat e ligjet ne fuqi te punesimit dhe te sigurimeve shoqerore e shendetesore per te gjithë te punesuarit ne Shoqeri, ndersa keta te fundit jane te detyruar te pranojne kete Statut te Shoqerise.



Neni 23

Te punesuarit ne Shoqeri pergjigjen sipas ligjit dhe sipas Statutit per moszbatimin e detyrave te caktuara, si dhe per demet qe ata i shkaktojne Shoqerise. Ata mbajne pergjegjesi penale dhe administrative per moszbatimin e detyrave te tyre.

Neni 24

Mosmarveshjet e te punesuaresh me Shoqerine zgjidhen nga gjykatat shqiptare. Kur pala ankuese eshte person i huaj, mosmarveshja zgjidhet nga organi i percaktuar ne kontraten e punes.

Neni 25

Punonjesit e emeruar nuk marrin pjese ne ndarjen e fitimit qe realizon Shoqeria, gjate ushtrimit te veprimtarise se saj ekonomike, nese ne kontraten e punes nuk eshte parashikuar ndryshe.

SEKRETI I PUNES

Neni 26

Te gjitha te punesuarit ne Shoqeri jane te detyruar te ruajne sekretin e punes se Shoqerise. Kjo detyre vazhdon edhe mbas largimit te tyre nga Shoqeria. Detyrimi per ruajtjen e sekretit te punes se Shoqerise eshte e vlefshme edhe per Ortaket dhe Administratoret e Shoqerise.

PERFAQESIMI I SHOQERISE

Neni 27

Perfaqesimi i Shoqerise Tregtare "**RevoTrade**" SHPK i perket ortakut te vetem, z. Renald Ngjeliu dhe/ose personave te autorizuar prej tij.

KONTROLLI I BRENDSEHEM

Neni 28

Kontrolli mbi veprimtarin e Administratorit, veprimtarine e tij si dhe te gjitha aktivitetin e shoqerise i besohet nje ekspertit ose revizori kontabel. Ky ekspert mund te qendroje ne detyre per 5 vjet dhe mund te rizgjidhet nga Asambleja e Shoqerise sipas dispozitave ligjore te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare",

BILANCI DHE TE ARDHURAT

Neni 29

Viti financiar i Shoqerise mbyllet ne 31 dhjetor te cdo viti. Ne mbylljen e cdo viti financiar, Administratori i Shoqerise ben inventarin dhe llogarite vjetore, ne perputhje me dispozitat ligjore mbi kontabilitetin, si dhe harton nje raport me shkrim per administrimin. Raporti i administrimit, inventaret dhe llogarite vjetore te hartuara nga Administratori, i nenshtrohen miratimit te Asamblese se Ortakeve brenda nje afati prej 6 muajsh, duke filluar nga data e mbylljes se vitit financiar.

Neni 30

Shoqeria nga fitimi i rezervuar gjate vitit financiar, pasi te jene zbritur po te jete e nevojshme humbjat e vitit te meparshem, le menjane nje shume me vlere te pakten 1/20 e tij, e cila destinohet per formimin e nje fondi rezerve te quajtur "rezerve e domosdoshme".

Neni 31

Ne seline e Shoqerise mbahet dokumentacion i plote i saj, dokument themeluese te Shoqerise, si dhe dokumentet qe rregullojne marredheniet ekonomike te Shoqerise, me te gjitha ndryshimet e bera deri ne ditet e fundit.



PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE

Neni 32

Prishja e Shoqerise mund te vije ne çdo kohe dhe per çfaredo shkak, si ne rast falimentimi, privimim i te drejtave per te ushtuar profesionin tregtar, forca madhore dhe çdo faktor tjetër qe nuk varet nga vullneti i Ortakeve te Shoqerise, por gjithmone me vendim te mbledhjes se jashtezakonshme te Asamblese se Ortakeve te shoqerise si dhe ne baze te ligjit. Ne keto raste Asambleja vendos mbi menyren e likuidimit te Shoqerise, duke caktuar nje ose me shume likuidatore, me pelqimin e shumices per nga kapitali te ortakeve dhe percakton detyrat e tyre. Ne rast likuidimi te Shoqerise, emertimi i saj do te pasohet nga shenimi "Shoqeri ne likuidim e siper". Ky shenim dhe emri i likuiduseit ose i likuiduesve duhet te figurojne ne te gjitha aktet e dokumentet e nxjerra nga shoqeria dhe qe u drejtohen te treteve. Likuidatoren dhe administratoren jane pergjegjes per veprimet e tyre dhe likuidimin e Shoqerise. Ata kujdesen per te likuiduar ne rradhe te pare detyrimet e Shoqerise ndaj te treteve. Ndarja e kapitaleve te veta, qe mbeten pas pagimit te kreditoreve dhe te pjeseve te kapitalit themeltar, behet ndermjet ortakeve, ne perpjestim te njejte me kontributin e tyre ne kapitalin themeltar. Ortaket thirren ne fund te procesit te likuidimit qe te vendosin per bilancin financiar perfundimtar, per aktin e rregullueshmerise per administrimin nga ana e likuiduesit dhe per heqjen e mandatit te tij si likuidues si dhe per te evidentuar mbylljen e likuidimit. Mbasi behet njoftimi i mbylljes se likuidimit dhe kryhen formalitetet e nevojshme te likuidimit, Shoqeria ç'regjistrohet.

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 33

Persa nuk eshte shprehur ne kete Statut i referohemi Ligjit Nr. 9901 dt 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" Ligjit Nr. 9723 dt. 03.05.2007 per "Qendren Kombetare te Regjistrimit" dhe rregullores se brendshme te shoqerise. Çdo ndryshim behet ne te njejten menyre siç eshte nxjerre ky Statut dhe nuk prek personalitetin juridik te formes SHPK.

Neni 34

Ky akt themelimi dhe statut perpilohet ne kater kopje; nje per Qendren Kombetare te Regjistrimit, nje per Zyren e Tatim - Taksave per marrjen e lejes se ushtrimit te veprimtarise dhe dy kopje mbetet si pjese e dokumentacionit te themelimit te Shoqerise. Njekohesisht ai nenshtkтуhet regullisht nga Ortaku i Vetem i Themelues Shoqerise "**RevoTrade**" SHPK z. Renald Ngjeliu.

"RevoTrade" shpk

Perfaqesuar nga Administratori,

Renald Ngjeliu

